



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS**

*2 - 4 Mars 2026 Universiteti i Arteve*

**KONKURSI I INTERPRETUESVE**

**“YMER SKËNDERI”**

**EDICIONI II**

Konkursi i Interpretuesve “Ymer Skënderi” organizohet për herë të dytë në Universitetin e Arteve në Tiranë, sipas traditës më të mirë të shkollave të ngjashme në Europë dhe më gjerë.

**Qëllimi**

Ky konkurs ka si qëllim kryesor:

- Promovimin e artistëve të rinj studentë pranë UART dhe nga gjithë shkollat e ngjashme në botë si dhe rritjen e interesit për të studiuar në institucionin tonë;
- Promovimin e Universitetit të Arteve në arenën mbarëkombëtare dhe më gjerë;

**Rregullorja e Konkursit**

***Fazat e Konkursit***

Konkursi do të zhvillohet në dy faza:

1. Faza e parë është konkursi brenda kategorisë ku do ndahen tre çmime;
2. Faza e dytë është konkursi për Çmimin e Madh ku do kualifikohen vetëm fituesit e çmimit të parë sipas kategorive.

***Kategoritë***

Konkursi ndahet në 7 (shtatë) kategori ku çdo kategori mban e emrin e një muzikanti të shquar i cili ka kontribute të rëndësishme, jo vetëm si artist por edhe në drejtim të mësimdhënies pranë Konservatorit të Tiranës, Institutit të Lartë të Arteve më vonë Akademia e Arteve sot Universiteti i Arteve.

- A. Kategoria Violinë - **“Ibrahim Madhi”;**
- B. Kategoria Harqe, që përfshin Violë, Violonçel, Kontrabas - **“Gjergj Antoniu”;**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- C. Kategoria Piano - **“Tonin Guraziu”**;
- D. Kategoria Frymë - **“Viktor Shiroka”**;
- E. Kategoria Kanto - **“Gaço Çako”**;
- F. Kategoria muzikë Dhome ku përfshihen të gjithë instrumentistët të cilët mund të konkurojnë me grupe të muzikës së dhomës deri në Oktet – **“Simon Gjoni”**.
- G. Kategoria Fizarmonikë, Kitarë Klasike, Muzikë Jazz – **“Agim Krajka”**

### **Çmimet**

Çmimet e Konkursit ndahen sipas kategorive ku jepen 3 (tre) çmime për çdo kategori për fazën e parë, përkatësisht:

- **Çmimi i Parë – 25.000 lekë** si dhe koncert si solist në shoqërimin e një prej ansambleve të shkollës (orkestrat e harqeve ose të frymës) për kategoritë A; B; C; D; E.
- **Çmimi i Dytë – 17.000 lekë**
- **Çmimi i Tretë – 10.000 lekë**

*Këto çmime mund të ndahen edhe “ex aequo”.*

### **Çmimi i Madh – “Ymer Skënderi”**

Çmimi i Madh i jepet fituesit të fazës së dytë ku konkurojnë fituesit e çmimit të parë për çdo kategori.

- **Çmimi i Madh – 35.000 lekë** si dhe koncert si solist me Orkestrën Simfonike të Fakultetit të Muzikës ose me OSFA

***Gjithashtu fituesit e çmimeve nga trupa e studentëve të UART, do të kenë prioritet në përzgjedhjen e tyre për programin ERASMUS+***

### **Programi i detyrueshëm**

#### **Faza e Parë**

Në fazën e parë, konkurentët për kategoritë A, B, C, D, duhet të paraqesin para jurive 2 vepra të stileve të ndryshëm nga të cilat njëra duhet të jetë koha e parë e një Koncerti ose Sonate me një kohëzgjatje të përgjithshme deri në 20 minuta.

Për kategorinë E, duhet të paraqesin para jurisë 2 Arie/Romanca të stileve të ndryshëm nga të cilat njëra duhet të jetë Arie e Madhe nga Operat, me një kohëzgjatje të përgjithshme deri në 15 minuta.

Për kategorinë F, konkurentët duhet të paraqesin 2 (dy) vepra nga të cilat njëra duhet të jetë vepër ciklike origjinale (2 kohë) ose 1 një vepër e plotë ciklike origjinale, me një kohëzgjatje të përgjithshme deri në 20 minuta.



Për kategorinë G, konkurentët duhet të paraqesin para jurive 2 vepra të stileve të ndryshëm me një kohëzgjatje të përgjithshme deri në 20 minuta.

### ***Faza e Dytë***

Në fazën e dytë, fituesit e kategorive duhet të paraqesin një vepër sipas dëshirës së tyre deri në 12 minuta ku nuk përjashtohet interpretimi i një prej veprave të luajtura në fazën e parë. Fituesit e kategorive (përveç kategorisë F) do të shoqërohen nga Orkestra Sinfonike e Forcave të Armatosura.

### ***Juritë***

Konkurimet e fazës së parë do të vlerësohen nga juri të përbërë nga 5 anëtarë, kurse konkurimi i fazës së dytë do të vlerësohet nga një juri e përbërë nga 9 anëtarë.

Juritë e konkursit përbëhen nga personalitete të shquara të fushave përkatëse, shqiptarë ose të huaj, të cilët përzgjidhen nga Dekanati i Fakultetit të Muzikës.

Gjykimi i jurive të konkursit është përfundimtar dhe i pa-apelueshëm.

### ***Pjesëmarrja***

Në këtë konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë studentë nga Universiteti i Arteve dhe IAL të ngashme nga gjithë bota, të cilët vërtetojnë se janë studentë gjatë kohës së zhvillimit të konkursit dhe/ose nxënës të shkollave artistike.

Aplikimi për pjesëmarrjen në konkurs do të realizohet përmes formularëve online.

Afati i fundit për aplikim do të jetë 10 ditë përpara fillimit të konkursit.

### **Edicioni i II-të nuk ka pagesë (Fee) për regjistrimin dhe pjesmarrjen.**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim përbëhet nga formulari online i plotësuar, dokument identifikimi me fotografi dhe një dokument i lëshuar nga institucioni ku studion kandidati/ja që vërteton specialitetin e studimit, vitin e studimeve.

Në rastin e kandidatëve që nuk mund të jenë prezent pranë Fakultetit të Muzikës në ditën e konkurimit, është detyrim i kandidatit/es të sigurojë një lidhje online interneti të qëndrueshme për të komunikuar me jurinë e konkursit dhe realizuar performancën e tij/saj.

Universiteti i Arteve nuk është përgjegjës për garantimin e strukturave akomoduese apo shpenzime të tjera (udhëtim, ushqim) të lidhura me pjesëmarrjen në konkurs.

Universiteti i Arteve nuk është përgjegjës për dëmtimet e mundshme të instrumentave muzikore të konkurentëve gjatë ditëve të pjesëmarrjes në konkurs.



## Një jetëshkrim i shkurtër i personaliteteve emrin e të cilëve mbajnë çmimet e këtij konkursi



*Ymer Skënderi lindi në Dibër më 17 mars të vitit 1926 dhe u nda nga jeta në Tiranë më 25 Korrik të vitit 1975. Ai ka qenë një nga personalitetet më të rëndësishëm të muzikës shqiptare. Ai ka qenë jo vetëm një violonçelist i shquar, por edhe pedagog dhe kompozitor. Në vitet 1947-1953 kryen studimet e larta për violonçel në Konservatorin Shtetëror të Pragës, Çekosllovakia. Në vitin 1953, sapo mbaron studimet, kthehet në Shqipëri dhe së bashku me të shoqen Ludmilla Ymeri (Shinderbalova), hapin klasën e parë të violonçelit në Liceun Artistik Jordan Misja. Më pas emërohet shefi i katedrës së instrumentave në Konservatorin Shtetëror të Tiranës (sot, Universiteti i Arteve).*

*Në repertorin koncertal të Ymer Skënderit përfshihen kryeveprat e literaturës klasike dhe romantike të violonçelit. Këtë repertor ai e luajti në koncertet e shumta brenda dhe jashtë Shqipërisë, në Çekosllovakia, Bashkimin Sovjetik, Jugosllavi, Rumani, Bullgari, Poloni, Hungari etj.*

*Por ajo që muzika shqiptare i detyron më shumë Ymer Skënderit është krijimi i një brezi të shquar të instrumentistëve shqiptarë të violonçelit dhe muzikës së dhomës. Nga klasa e tij kanë dalë të gjithë violonçelistët e shquar shqiptarë të brezit të vjetër e të mesëm si: Gj. Lazri, M. Denizi, G. Laro, Gj. Antoniu, etj.*



*Ibrahim Madhi u lind në Tiranë më 1945. Pasi mbaron ciklin e plotë të studimeve në Liceun Artistik "J.Misja" Tiranë në 1963, diplomohet në Institutin e Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve) në 1968 me rezultate të shkëlqyera. Në vazhdim (1973) ai i kompletion studimet e tij violinistike me një specializim pasuniversitar pranë konservatorit "San Pietro a Maiella" në Napoli Fillimet e aktivitetit të tij pedagogjik i përkasin vitit 1962, më parë si mësues i klasës së violinës në Liceun Artistik "J. Misja" dhe më pas, në 1965, prane I.L.Arteve. Për më shumë se 40-vjet karrierë pedagogjike, ai ka pregatitur breza të tërë violinistësh e muzikantësh të spikatur.*

*Emri i tij lidhet jo vetëm si një solist brilant, por në të njëjtën kohë edhe një drejtues i përkryer i grupeve të muzikës së dhomës dhe orkestrës së harqeve. Brohoritja për shkollën Shqiptare të interpretimit violinistik, nuk mund të kuptohet pa emrin e Ibrahim Madhit si një ndër figurat qëndrore të kësaj shkolle. Është një ndër figurat më të rëndësishme të muzikës dhe artit të interpretimit Shqiptar. I njohur për formimin dhe muzikalitetin e tij, muzikanti i shquar ka*



dhënë një kontribut të çmuar në formatimin e shkollës kombëtare të interpretimit muzikor. Për meritat dhe kontributin e tij të veçantë, ai gëzoi titullin më të lartë të artit në Shqipëri: “Artist i Popullit”. Ai ka interpretuar në qindar koncerte në skenat e Shqipërise, Kosovës, Turqisë, Rumanisë, Kinës, Greqisë, Italisë, Austisë, Francës, Gjermanisë, Zvicrës etj. duke marrë vlerësime dhe duartokitje të gjata.

Është themelues dhe anëtar i trios së I.L. Arteve si dhe i Orkestrës së mirënjohur të Harqeve të këtij institucioni, duke ndihmuar dhe dhënë një kontribut direkt në formimin e traditës së lojës në këto ansamble që u bënë të mirënjohura për publikun.

Me përgjegjësi dhe kualitet të lartë artistik ka interpretuar pothuajse të gjithë repertorin violinistik shqiptar, duke i bërë premierën shumicës së tyre. Ai ka shumë inçizime e regjistrime në studio apo direkt nga sallat e koncerteve me Radio Tiranën, Televizionin Shqiptar, Radio Prishtinën, Radion e Pekinit (Kinë), Radion e Gracit (Austri) etj., të cilat vazhdojnë të jenë në transmetim.



**Gjergj Antoniu** lindi në Tiranë në vitin 1949. Studioi në Akademinë e Lartë të Arteve. Nga viti 1973 ai interpretoi mbi 100 pjesë muzikore të huaja dhe shqiptare dhe bashkëpunoi me kompozitorët më në zë vendas. Përpos koncerteve në Shqipëri dhe jashtë kufijve të vendit, Gjergj Antoniu punoi edhe si mësues në Liceun Artistik Jordan Misja dhe më pas profesor në Akademinë e Arteve.

Në karrierën e tij të gjatë artistike u nderua me një sërë çmimesh si dhe me titullin Artist i Merituar.

Gjergj Antoniu, 12.4.1949 – 28.9.2012, violinçelisti virtuoz me individualitet të spikatur, poet i tingullit, profesionist dhe erudit, Gjergj Antoniu renditet në një vend të rëndësishëm në jetën muzikore elitare shqiptare. Një peshë më vete në rrugëtimin e tij artistik zë interpretimi i literaturës shqiptare, siç shprehej ai, “si një detyrim moral artistik, në respekt të të gjithë kompozitorëve shqiptarë të traditës e të brezit të ri”. Ai vlerësoi nuancat dhe ngjyrimet kombëtar dhe i vuri në jetë duke zbuluar dhe mjetet korrekte për realizimin e tyre. Gjergj Antoniu vlerësohet nga kritika jo vetëm si interpretues, por gjithashtu si stimulues e frymëzues në krijimin e këtyre veprave.

Në veprimtarinë e tij zë një vend të rëndësishëm edhe puna 36-vjeçare si pedagog në ILA më pas Akademia e Arteve sot Universiteti i Arteve.



**Tonin Guraziu, 1908-1999.** I lindur në [Shkodër](#), Tonin Guraziu vendoset familjarisht në 1912 në [Itali](#), ku kreu shkollën fillore dhe të mesme.<sup>[1]</sup>



Pasi u diplomua në Akademinë Mbretërore të [Bolonjës](#), ku u vlerësua me notën maksimale (30/30), në vitin [1931](#), ai kthehet në Shqipëri, ku do të nisë dhe serinë e koncerteve të para që do të shënonin nisjen e veprimtarisë së brezit të parë të artistëve profesionistë shqiptarë.

- Tonin Guraziu është pianisti i parë shqiptar i diplomuar nga një Akademi Filarmonike Europiane (La Regia Acaademia Filarmonica di Bologna, 29.03.1931).
- Tonin Guraziu është koncertmaestri i vënieve të para në skenë të veprave operistike në Shqipëri.
- Tonin Guraziu është pianisti i parë shqiptar që në bashkëpunim me Orkestren Simfonike të Filarmonisë së Tiranës përformuan në mjedisin e Teatrit Popullor Tiranë në vitin 1954 koncertin për piano e orkester të kompozitorit Grieg.
- Tonin Guraziu është themeluesi i katedrës së pianos pranë Liceut Artistik në Tiranë.
- Tonin Guraziu është themeluesi i katedrës së pianos pranë Institutit të Lartë të Arteve.

E megjithatë skena mbetet mbretëria e tij. Sfidoi vitet e shumta që mbante mbi shpinë, dhe në moshën 88-vjeçare ngjitet në skenën e qytetit të tij të lindjes për të dhënë një koncert të organizuar në përkujtim të 60 vjetorit të "Koncertit të parë me muzikë klasike në historinë e muzikës klasike shqiptare (Shkodër, Mars 1936), kurse në moshën 90 vjeçare ( Prill 1998) përformon me sukses koncertin e tij ( të fundit) në skenën prestigjioze të Teatrit të Opera e Baletit – Tiranë Ai ka intepretuar sëbashku me disa prej personaliteteve të artit shqiptar të kohës si Marie Paluca (Kraja), Tefta Tashko Ishte viti i largët 1936, muaji mars. Shënohet mbajtja e të parit koncert operistik në Shqipëri.

Pjesët pianistike të kompozura nga pianisti Guraziu, gjatë periudhës së diktaturës së proletariatit në Shqipëri, për të parën herë janë botuar në librin "Tonin Guraziu, një jetë në piano"



**Viktor Shiroka** lindi në vitin 1941 vinte nga një familje me traditë në botën e kulturës. Në vitin 1957, pas përfundimit të liceut në Tiranë, Shiroka nisat drejt Pragës, ku studioi për oboe deri në vitin 1961, kohë në të cilën dhe diplomohet. Pas kthimit në Shqipëri e pret një jetë e ngjeshur artistike. Në 1962-shin krijohet "Orkestra Simfonike e Radios dhe Kinematografisë", (sot Orkestra e RTSH-së), ku filloi punën si oboist i parë. Me këtë orkestër ai ka interpretuar kompozitorët më të mëdhenj botërorë. Por, e veçanta e tij është se ka luajtur i pari të gjitha pjesët e shkruara për oboe nga kompozitorët shqiptarë, si "Variacione për oboe dhe orkestër", Josif Minga, "Koncert për oboe dhe orkestër", Feim Ibrahim, etj.

Paralelisht, Shiroka vazhdon të jepte mësim në Konservatorin e Tiranës. Ai është krijuesi i klasës së Oboes në ILA sot UART. Në klasën e tij janë diplomuar disa prej oboistëve më të mirë të vendit.




**Gaqo Çako**, Artist i Popullit, është rreshtuar në emrat e mëdhenj të panteonit të muzikës shqiptare. Ai lindi në Korçë më 1935. Në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare ai nisi të studiojë për kanto në Liceun Artistik të Tiranës nën udhëzimet e Mihal Cikos dhe pak më vonë e më gjatë të Jorgjie Trujës. Midis viteve 1957 dhe 1961 ai studioi në konservatorin “Çajkovski” të Moskës nën drejtimin e pedagoges Anna Soloviova. Pas kthimit në Shqipëri më 1961 ai u emërua tenor i përhershëm i Teatrit të Operës dhe Baletit të Tiranës, ku këndoi shumë nga rolet e para të repertorit operistik, duke u bërë kështu tenori kryesor për tri dekada me radhë.

Ai ka studiuar edhe në konservatorin Santa Cecilia në Romë.

Gaqoja u vlerësua jo vetëm për zërin e pastër prej tenori, por edhe për intonacionin rrezatues, për ngjyrimin e veçantë, ashtu dhe për diksionin e kthjellët me ato bashkëtingëlloret e formuara me kujdes gjithnjë në ruajtje e kontroll të vazhdueshëm të sensit të sigurt ritmik.

Janë me dhjetra role të para që ai këndoi në opera si të repertorit operistik botëror ashtu edhe në operat kompozitorëve shqiptarë ku ka performuar në disa premiera të tyre.

Të qenit pedagog i kantos për vite me radhë në shkollën e lartë të arteve në Tiranë bënë që në një moment të caktuar të karrierës së tij artistike, përveç mësimdhënies Gaqoja të vihej edhe në rolin e regjisorit operistik. Edhe pse vlerën më të madhe ai e pati në interpretimet e roleve operistike, ai u popullarizua nëpërmjet këngës, veçanërisht atyre të Festivaleve të Radios.



**Simon Gjoni** u lind në qytetin e Shkodrës më 28 tetor 1925. Simon Gjoni është artisti që ka njëherësh disa vlera, si muzikant, si kompozitor, si dirigjent, si pedagog, një artist shumëplanësh, emri i të cilit lakohet edhe sot me respekt e nderim jo vetëm mes artistëve shqiptarë, por edhe në botë, si pjesë e enciklopedive dhe literaturave muzikore, ku luhet krijimtaria e tij më e mirë dhe përfaqësuese. Megjithëse u largua fizikisht nga jeta ai la pas emrin e tij, muzikën, këngët e bukura dhe mbi të gjitha la pas “luleborën”, një himn që do ta shoqërojë brez pas brezi dhe e bën atë të pavdekshëm. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në kolegjin françeskan në qytetin e lindjes. Që kur ishte fëmijë është pjesëmarrës aktiv i grupit koral të shkollës dhe më vonë me instrumentin e trompës është anëtar i bandës së fëmijëve së bashku me Tish Dainë, Tonin Harapin, Çesk Zadenë, etj, me drejtues kompozitorin e



mirënjohur Prenkë Jakova. Pasi mbaroi gjimnazin iu kushtua një aktiviteti të dendur muzikor. Disa nga krijimet e tij më të mira u përmbledhën në dy përmbledhje “Album për piano” dhe “Album me romanca”. Studimet e larta i kryen në vitet 1952- 1958 në Akademinë e Lartë Muzikore të Pragës, në klasën e dirigjimit simfonik me profesorët V. Smetacek, R. Brook, dhe A. Klima. Në vitin 1954 është pjesëmarrës si kompozitor në Festivalin Internacional të Muzikës, së bashku me kolosët botërore, kompozitorë dhe instrumentistë si Shaporin, Janson, Rihter, Shafran, Fisher, Fournet, etj. Në vitin 1956 në sallën “Mestska Knihovna” drejton Shubert “Rosamunda” dhe Grieg “Perr Gynt”, veprën “Pygmalion” të kompozitorit Jiri Benda. Në vitin 1957 në sallën “Dum Umelcu” drejton “Simfoninë koncertale për violinë e kontrabas” të K. Dittersdorf. Suksesi i këtij koncerti pasohet nga ai i pjesës simfonike të Franc Liszti -it “Les Preludes”. Një ndër dirigjentët e parë të orkestrave tona simfonike të Teatrit të Operas dhe Baletit dhe të Radio Televizionit. Në 1958 emërohet dirigjent në TOB. Shumë vepra të shquara e gjetën interpretimin e parë” tek dirigjenti i ri, i cili i interpretoi ato duke zbuluar ngarkesën emocionale të tyre me një ndjeshmëri të lartë. Për herë të parë me kujdesin dhe pasionin e tij inçizoi krijimtarinë e deriatëhershme të kompozitorëve shqiptarë Zadeja, Gaci, Nova, Grimci, Daia, Kono, Zoraqi, Harapi, gjithashtu edhe muzikën e disa filmave shqiptarë. Duhet veçuar aktiviteti i tij si pedagog, ku ai dha një kontribut të çmuar deri na çastet e fundit të jetës, ku përgatiti me dhjetëra studentë, e filloi në vitin 1958 në Liceun Artistik. Më 1961 është një ndër pedagogët e parë me themelimin e Konservatorit Shtetëror të Tiranës së bashku me Zadenë, Guraziun, Skënderin, etj, ku jepte mësim në lëndët e Intonacionit, Polifonisë, Dirigjimit dhe Muzikën e Dhomës.



**Agim Krajka** u lind në Kavajë në gjirin e një familje me origjinë dibrane. Babai i tij ishte i pasionuar pas muzikës, dhe si amator luante në disa instrumente muzikore, si violinë, mandolinë, fizarmonikë. Dashuria dhe pasioni për muzikën tek Agimi lindën që në fëmijëri, të cilën ja ushqeui edhe vetë i ati. Fizarmonika u bë shkak që vajti në Shtëpinë e Pionierit, ku filloi të merrej seriozisht me të. Në vitin 1963 Agimi fillon studimet për teori e kompozicion. Degën e Kompozicionit e ka kryer nën drejtimin e kompozitorit Çesk Zadeja. Në vitin 1964 kalon pranë Ansambllit të Këngëve dhe Valleve popullore; si instrumentist, si kompozitor dhe drejtues orkestre. Veprimtaria e tij muzikore është shumë e gjërë dhe e larmishme, duke përfshirë një periudhë prej katër dekadash. Ka shkruar muzikë në shumë lloje dhe është bërë i famshëm si me muzikën e lehtë, ashtu edhe më atë popullore, të krijuar, të përpunuar e orkestrale. Ka kompozuar shumë pjesë orkestrale për fizarmonikë, që përbëjnë një dukuri të re në muzikën shqiptare, si nga gjuha melodike, ashtu edhe nga harmonia shumë e pasur dhe moderne për kohën. Kompozoi një pjesë të mirë të valleve të Ansambllit Shtetëror, duke u bazuar thellësisht në folklorin e të gjitha trevave të Shqipërisë. Kompozoi dhe mjaft këngë të muzikës së lehtë, të cilat ishin shumë të dashura për rininë, dhe



*karakterizoheshin për stilin unik dhe modern, si në melodi, ashtu edhe në harmoni e orkestracion. Ka marrë pjesë në shumë festivale të muzikës deri në festivalet e fundit të pasviteve '90. Drejtoi grupin "Kompleksi ritmik" në disa nga festivalet e para. Ai është nderuar me mbi 15 çmime të dyta, 3 çmime të treta dhe vetëm një çmim të parë në Festivalin e vitit 1987.. Kompozoi edhe shumë muzikë për filma, si Njësiti Gueril, Çifti i lumtur, Zonja nga qyteti, Një shoqe nga fshati, "Në pyjet me borë ka jetë", "Lundrimi i parë", "Zëvendësi i grave" dhe "Zemërimi i shkronjave"*

*I është dhënë titulli Artist i Popullit dhe Nder i Kombit.*